



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo

ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY



PSH. nr. 304/19

PANELI SHQYRTUES, i emëruar nga Kryetari i OSHP-së në bazë të nenit 105 dhe nenit 106 të Ligjit për Prokurim Publik të Kosovës nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/ L-068, dhe Ligjin 05/ L-092, në përbërje z. Nuhi Paçarizi- Kryetar, z. Blerim Dina – Referues, z. Goran Milenković – Anëtar, duke vendosur sipas ankesës së parashtruar nga operatori ekonomik “Ilir Kosova” shpk, kundër njoftimit për dhënie të kontratës së aktivitetit të prokurimit me titull: “Furnizim me paisje teknologjike për objektet komunale dhe bashkësitë lokale- LOT 2” me nr. të prok: 616-1461-121, iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) – Komuna e Prishtinës, më datën: 05. 07. 2019 mori këtë:

V E N D I M

I. APROVOHET, pjesërisht si e bazuar ankesa e operatorit ekonomik “Furnizim me paisje teknologjike për objektet komunale dhe bashkësitë lokale- LOT 2” me nr. të prok: 616-1461-121, iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) – Komuna e Prishtinës.

II. VËRTETOHET, njoftimi për dhënie të kontratës së aktivitetit të prokurimit me titull “Furnizim me paisje teknologjike për objektet komunale dhe bashkësitë lokale- LOT 2” me nr. të prok: 616-1461-121, iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) – Komuna e Prishtinës.

IV. Autoriteti Kontraktues në afat prej 10 ditësh duhet ta informoj me shkrim Panelin Shqyrtues për të gjitha veprimet e ndërmarra lidhur me këtë aktivitet të prokurimit.

V. Mos respektimi i këtij vendimi, detyron Panelin shqyrtues që konform dispozitave ligjore të nenit 23.9 dhe 131 të Ligjit për Prokurim Publik të Kosovës nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/ L-068, dhe Ligjin 05/ L-092, të ndërmarr masa ndaj Autoritetit Kontraktues.

VI. Me qenë se ankesa e operatorit ekonomik ankues aprovohen pjesërisht si e bazuar, i bëhet kthimi i tarifës së ankesës në shumën e deponuar me rastin e parashtrimit të ankesës.

VII. Obligohen operatorët ekonomik ankues që konform nenit 33 pika 6 të rregullores së punës së OSHP-së, në afat prej gjashtëdhjetë (60) ditësh të bëjë kërkesë për kthim të sigurimit të ankesës, në të kundërtën ju bëhet konfiskimi i depozitës dhe këto mjete kalojnë në Buxhetin e Republikës së Kosovës.

A R S Y E T I M

Njoftimi për kontratë në lidhje me këtë aktivitet të prokurimit është bërë me dt: 03.06.2019

Hapja e ofertave është bërë me dt: 18.04.2019

Data e njoftimit me letrën standarde për tenderues të pa suksesshëm: 03.06.2019

Data e kërkesës për rishqyrtim 30.05.2019

Autoriteti Kontraktues me datën 07.06.2019 ka marrë vendim që të refuzohet kërkesa për rishqyrtim si e pa bazuar.

Me datën: 11.06.2019 OE “Ilir Kosova” Sh.p.k – Prishtinë, ka parashtruar ankesë në OSHP, lidhur me aktivitetin e prokurimit “Furnizim me pajisje teknologjike për Objektet Komunale dhe Bashkuesit Lokale- LOT 2” me nr. të prokurimit: 616-19-14-611-2-1, iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) – KK Prishtinë.

Dispozitat e shkelura sipas OE ankues janë:

- Neni – Qëllimi i ligjit
- Neni 6- Ekonomiciteti dhe Efikasiteti
- Neni 7- Barazia në Trajtim/ Jo-Diskriminimi
- Neni 59.2 dhe pika 4- Ekzaminimi, Vlerësimi dhe Krahësimi i Tenderëve

Organi Shqyrtues i Prokurimit, konform nenit 113 dhe 114 të LPP-së me datë: 17.06.2019 ka autorizuar ekspertin shqyrtues profesional të prokurimit për të shqyrtuar vlefshmërinë e të gjitha pretendimeve të palës ankimore i cili në raportin e tij të ekspertizës ka konstatuar:

Përshkrimi	Specification teknik minimal i Kerkuar
------------	--

Modeli:	Printer All-In-One, Lexmark MB2442DW
Printer:	
Print Speed:	40 ppm (A4)
Memory:	512 MB
Printing Method:	Laser printing, Double Side Printing: Automatic
Interface:	Standard: USB 2.0, Ethernet, WiFi Network protocol: TCP/IP
Copier:	
Copy Speed:	40 ppm (A4)
Double Side Copying:	1-side to 2-side (automatic), RADF
Scanner:	
Type:	Colour
Scan to:	e-mail, Folder, FTP
Include:	USB Cable
Include:	Toner
Garancioni:	3 vite

Ndërsa, në ankesën e OE ankues në AK, përsëri ka refuzuar ankesën e OE ankues duke u përgjigj si në vijim;

2.

2.1. Tek pozicioni nr. 2 modeli qe është ofruar ne kolonën C është LEXMARK MB2442DW?

2.2. Është kërkuar Double side copying: DADF. ?

2.1. Kompania ka ofruar LEXMARK MB2442DW i cili nuk është printer AIO, ndërsa se bashku me ofertën ka ofruar një katalog me një lloj tjetër te printerit Lexmark MB2442ADWE i cili nuk është i njejt me llojin qe është ofruar ne kolonën C, ku është kërkuar te ceket me saktësi modeli i pajisjeve.

2.2. Është ofruar RDAF.

Pika ankimore nga më lartë nr 2, nënpika nr. 2.1.

Në Specifikacionin Teknik të Dosjes së Tenderit të shpallur nga vet AK-ja, nuk kemi has që është kërkuar Katalog për pajisjet e ofruara, edhe pse OE ankues ka bashkëngjit katalogun për pajisjen e ofertuar. Katalogu prezanton saktësisht modelin e printerit LEXMARK MB2442ADWE, ndërsa në kolonën C kanë deklaruar që do të ofrojnë modelin LEXMARK MB2442DW, model ky që nuk gjinden fare sipas

kërkimeve tona, sepse ndoshta gabimisht OE ankues ka shënuar DW në vend të ADWE. Modeli në katalog; LEXMARK MB2442ADWE është model i serisë së printerëve LEXMARK MB2400.

Nga URL linku i serive të printerëve të prodhuesit përshkruhet;

http://support.lexmark.com/index?page=oscompatibilitydocs&id=OS17&locale=EN&userlocale=EN_BE

Ndërsa, URL linku në vijim gjithashtu paraqet versionet e modeleve të serive të printerëve nga ku shihet që;

Seria MB2400 - përmban modelet MB2442ade, MB2442adwe.

http://support.lexmark.com/index?pmv=print&page=content&locale=EN&userlocale=EN_US&id=RE154

Prandaj, modeli MB2442 i takon familjes së printerëve të serisë MB2400. Në katalog përshkruhet modeli MB2442ADWE, ndërsa në kolonën C në DT është deklaruar printeri MB2442DW. OE ankues nëse do të zgjidhej si fitues potencial do të duhej të sjell printerin MB2442ADWE të familjes MB2400, sikurse e ka prezantuar përmes katalogu të pajisjes.

Përshkrimi i shkurtesave të shkronjave të printerit;

- M** – M është shkurtesë për fjalën Monochrome, gjegjësisht Multifunksionale me laser monokromatik.
- B** – B është shkurtesë për fjalën BeSecure (Sigurohuni), që dmth se printeri ndihmon në ruajtjen e informacionit për siguri. Dokumentet konfidenciale nuk shtypen derisa të futet PIN kodi i urdhëruesit për printim.
- A** – A është shkurtesë për fjalën Automatik (Automatik), që dmth printer ofron funksione automatike të veprimit.
- D** – D është shkurtesë për fjalën Duplex, që dmth se printeri mund të shtypë në të dy anët e një faqeje.
- Ë** – Ë është shkurtesë për fjalën Ëireless, që dmth se printeri ka aftësi të printimit përmes valëve pa kablo dhe atë nga kompjuterët, tabletat apo edhe telefonat e mençur.
- E** – E është shkurtesë për fjalën e Print, që dmth printer ka aftësi të printoj edhe nga Emili. Printerët të cilët janë MFP (Printerë me shumë funksione) zakonisht përmbajnë këtë funksionalitet.

Modeli i ofruar nga OE ankues përkrah këtë funksion.

- MFP** – MFP është shkurtesë për fjalën Multi-Function Printer (Printer me Shumë Funksione). Printerët MFP janë printer AiO "all-in-one" me funksione bonus përfshirë skanimin, kopjimin dhe faksin.

OE ankues ka ofruar printerin AiO apo MFP.

OE ankues me të drejte ka ofruar printerin AiO, sepse printeri ofron shërbimet AiO. Ndërsa AK nuk ka pas të drejtë të eliminoj nga gara tenderuese OE ankues për këtë pikë.

Nga ana tjetër, OE ankues në përshkrimin e vetë nuk e ka dhënë modelin e saktë që do të ofrojnë, e ndoshta është gabim teknik në kolonën C, sepse në hulumtimin tonë ne nuk kemi mund të gjejmë modelin e ofruar në kolonën C edhe pse është printer i serisë së familjes MB2400. Por kemi gjetë modelin e ofruar nga katalogu. E ftojmë OE ankues të sqarohet në seancën dëgjimore se a ka qenë gabim teknik modeli i dhënë i printerëve, edhe pse me katalog kanë dëshmuar modelin e saktë të printerit ofertues.

Pika ankimore nga më lartë nr 2, nënpika nr. 2.2.

AK në DT ka kërkuar që printeri të ketë funksionalitetin DADF, ndërsa OE Ankues ka ofruar RDAF.

DADF – DADF është shkurtesë për fjalinë Duplex Automatic Document Feeder, që dmth printeri skanon të dyja anët e faqeve në një kalim të vetëm në mënyrë automatike.

RDAF – RDAF është shkurtesë për fjalinë Reversing Automatic Document Feeder. Që dmth printeri skanon njërën anë të faqes, pastaj e rrotullon faqen me dorë në mënyrë manual dhe skanon anën tjetër.

AK me te drejtë ka atakuar OE ankues, sepse nuk ka ofruar saktësisht funksionalitetin e kërkuar të printerit në DT.

Eksperti teknik, bazuar në sqarimet e cekura më lartë në raport mendon që Autoriteti Kontraktues, AK – Komuna Prishtinës, për këtë aktivitet të prokurimit: “Furnizim me Pajisje Teknologjike për Objektet Komunale dhe Bashkësitë Lokale”, me nr. të Prokurimit:

616-19-045-1-2-1, REKOMANDON, panelit shqyrtues që të aprovoj pjesërisht të bazuar ankesën e OE ankues dhe njëherit AK-së të vazhdoj tutje me prokurimin e këtij aktiviteti deri në realizimi të suksesshëm të tij.

Operatori ekonomik OE ankues përmes parashtresës me shkrim të datës: 20 qershor 2019, ka njoftuar Panelin shqyrtues se nuk pajtohet me raportin e ekspertit shqyrtues.

Autoriteti Kontraktues përmes parashtresës me shkrim të datës: 02 korrik 2019, ka njoftuar Panelin shqyrtues se pajtohet me raportin e ekspertit shqyrtues.

Në seancën e shqyrtimit kryesor të datës 05.07.2019, ku kanë qenë prezent paneli shqyrtues, përfaqësuesi i autoritetit kontraktues dhe operatorit ekonomik ankues, u shqyrtuan shkresat e lëndës duke e bërë

kontrollimin dhe analizimin e dokumentacionit për procedurën e prokurimit i cili përbëhet nga: autorizimi i inicimit të aktivitetit të prokurimit, njoftimi për kontratë, njoftimi për anulim të aktivitetit, ankesat e operatorit ekonomik, raporti i ekspertit shqyrtues profesional, parashtrësit e palëve në procedurë.

Gjatë prezantimit në seancë të OE ankues deklaroj: “Pajtohem plotësisht me ekspertizën ekspertet kanë shtjelluar pikat ankimore në mënyrë profesionale dhe përkrahim ekspertizën propozoj të aprovohet ankesa e jonë e bazuar dhe lënda të kthehet në rivlerësim”.

Në vazhdim fjala iu dha përfaqësuesit të AK-së i cili deklaroj: “Në disa pika pajtohem por në disa nuk pajtohem. Fillimisht ne kemi kërkuar printer All in One këta e kanë ofruar një shifër Lexmark, tek pozicioni nr 2. Printeri nuk është All in One që është ofruar në kolonën C e cila kolonë ka qenë obligative të plotësohet saktësisht krahas kërkesave të Autoriteti Kontraktues e që shifra që është ofruar nuk është ajo e kërkuara ekziston me e vogël por nuk është modeli i kërkuar. Gjithashtu ne nuk kemi specifikacione detyruesisht, OE ka ofruar specifika, OE-te po bëjnë ndërhyrje në programe të ndryshëm dhe ne i verifikojmë, për këtë edhe nuk i kërkojmë specifikat obligative”.

Gjatë prezantimit në seancë eksperti teknik z. Hasani deklaroj: “Në pikën 1 Autoriteti Kontraktues e kundërshton ekspertizën tonë ne e kemi sqaruar detalisht në ekspertizë dhe kemi vërtetuar që kriteri i ofruar nga OE është All in One apo ndryshe quhet Multi Funkcional, dhe këtë e kemi sqaruar, kishim dashtë të dëgjojmë nga OE modelin që kanë shkruar në oferte sepse këtë model nuk kemi mundur të gjejmë saktësisht dhe ka mundësi që është bërë gabim teknik ku është harruar të shënohet në spec. teknik të ofertuar modelin MB 2442ADËE dhe OE ndoshta ka harruar shkronjën A dhe E. Ne e besojmë këtë sepse OE ka bashkëngjitur katalog dhe modelet i takojnë serisë së printerëve të familjes MB 2400 e që është pjesë e kësaj serie të printerëve prandaj këtë pikë ankimore e konsiderojmë të drejtë për OE-në, ndërsa për nënpikën nr 2.2 në raportin e dhënë kemi sqaruar këtë dhe pasi që është ankuar OE në raportin e ekspertizës me shkrim ne e kemi analizuar ankesën dhe kemi parë që nuk është trajtuar pika 2 nënpika 2.2 nga ana jonë dhe kemi bërë plotësim ku kemi kërkuar që plotësimi jonë të plotësojë pika 2 nënpika 2.2. Ne përgjigjën tonë me e-mail sikur se printeri nga pika 1 që është kërkuar AIO printer multi funksional njejt edhe të kjo pjesë e ADF janë tipare të ADF-ve, DADF dhe RADF e që të dyja këto tipare kryen të njëjtin funksion, prandaj pas plotësimit të ekspertizës sonë ne rekomandojmë që lënda të kthehet në rivlerësim dhe të rivlerësohet nga AK sepse OE ka të drejtë në ankesën e tij që do të thotë pas plotësimit të ekspertizës tonë tani ndryshon edhe propozimi jonë për rekomandim”.

Kryetari i panelit shqyrtues kërkoj nga ekspertet qe brenda 5 dite pune te përgatisin ekspertizën e kompletuar duke i shqyrtuar te gjitha pretendimet ankimore dhe duke dhenë përgjigje te qarta dhe te sakta si nga eksperti shqyrtues dhe ai teknik dhe palët do te pajisen me këtë raport pastaj paneli pret përgjigje me shkrim nga palët, përgjigjet duhen te jenë te qarta te shkurta duke u bazuar ne prova dhe seance tjetër pa praninë e palëve do te vendoset lidhur me këto pretendime.

Pas kërkesës së kryetarit të panelit shqyrtues që eksperti shqyrtues brenda 5 ditë ta plotësoj raportin e ekspertizës, eksperti shqyrtues teknik në raportin e datës 11. 07. 2019 ka deklaruar:

Të gjitha pretendimet ankimore janë shqyrtuar nga eksperti teknik

Specifikacioni Teknik i kërkuar në Dosje të Tenderit, inicuar nga
Autoriteti Kontraktues për Lot II, artikulli nr. 1.

Përshkrimi	Specifikacioni teknik minimal i kërkuar
Modeli:	Printer All-In-One (Të specifikohet emri i modelit të ofruar)
Printer:	
Print Speed:	UP to 38 -40 ppm (A4)
Memory:	512 MB
Printing Method:	Laser printing, Double Side Printing: Automatic
Interface:	Standard: USB 2.0, Ethernet, Network protocol: TCP/IP
Copier:	
Copy Speed:	Up to 38-40 ppm (A4)
Double Side Copying:	1-side to 2-side (automatic), DADF
Scanner:	
Type:	Colour
Scan to:	e-mail, Folder, FTP
Include:	USB Cable
Include:	Toner
Garancioni:	3 vite

Specifikacioni Teknik i ofruar në Dosje të Tenderit nga
Operatori Ekonomik Ankues për Lot II, artikulli nr. 1.

Përshkrimi	Specifikacioni teknik minimal i kërkuar
Modeli:	Printer All-In-One, Lexmark MB2442DW
Printer:	
Print Speed:	40 ppm (A4)
Memory:	512 MB
Printing Method:	Laser printing, Double Side Printing: Automatic
Interface:	Standard: USB 2.0, Ethernet, WiFi Network protocol:

	TCP/IP
Copier:	
Copy Speed:	40 ppm (A4)
Double Side Copying:	1-side to 2-side (automatic), RA DF
Scanner:	
Type:	Colour
Scan to:	e-mail, Folder, FTP
Include:	USB Cable
Include:	Toner
Garancioni:	3 vite

Sasia e kërkuar të artikullit nga ana AK; 50 copë.

Ndërsa, në ankesën e OE ankues në AK, përsëri ka refuzuar ankesën e OE ankues duke u përgjigj si në vijim;

2.

2.1. Tek pozicioni nr. 2 modeli që është ofruar ne kolonën C është LEXMARK MB2442DW ?

2.2. Është kërkuar Double side copying: DADF. ?

2.1. Kompania ka ofruar LEXMARK MB2442DË i cili nuk është printer AIO, ndërsa se bashku me ofertën ka ofruar një katalog me një lloj tjetër te printerit Lexmark MB2442ADËE i cili nuk është i njejt me llojin që është ofruar ne kolonën C, ku është kërkuar te ceket me saktësi modeli i pajisjeve.

2.2. Është ofruar RDAF.

Pika ankimore nga më lartë nr 2, nënpika nr. 2.1.

Në Specifikacionin Teknik të Dosjes së Tenderit të shpallur nga vet AK-ja, nuk kemi has që është kërkuar Katalog për pajisjet e ofruara, edhe pse OE ankues ka bashkëngjit katalogun për pajisjen e ofertuar.

Katalogu prezanton saktësisht modelin e printerit LEXMARK MB2442ADWE, ndërsa në kolonën C kanë deklaruar që do të ofrojnë modelin LEXMARK MB2442DW, model ky që nuk gjendet fare sipas kërtimeve tona, sepse ndoshta gabimisht OE ankues ka shënuar DW në vend të ADWE. Modeli në katalog; LEXMARK MB2442ADWE është model i serisë së printerëve LEXMARK MB2400.

Nga URL linku i serive të printerëve të prodhuesit përshkruhet;

http://support.lexmark.com/index?page=oscompatibilitydocs&id=OS17&locale=EN&userlocale=EN_BE

Ndërsa, URL linku në vijim gjithashtu paraqet versionet e modeleve të serive të printerëve nga ku shihet që;

Seria MB2400 - përmban modelet MB2442ade, MB2442adëe.

http://support.lexmark.com/index?pmv=print&page=content&locale=EN&userlocale=EN_US&id=RE154

Prandaj, modeli MB2442 i takon familjes së printerëve të serisë MB2400. Në katalog përshkruhet modeli MB2442ADËE, ndërsa në kolonën C në DT është deklaruar printeri MB2442DW. OE ankues nëse do të zgjidhej si fitues potencial do të duhej të sjell printerin MB2442ADWE të familjes MB2400, sikurse e ka prezantuar përmes katalogu të pajisjes.

Përshkrimi i shkurtesave të shkronjave të printerit;

- M** – M është shkurtesë për fjalën Monochrome, gjegjësisht Multifunksionale me laser monokromatik.
- B** – B është shkurtesë për fjalën BeSecure (Sigurohuni), që dmth se printeri ndihmon në ruajtjen e informacionit për siguri. Dokumentet konfidenciale nuk shtypen derisa të futet PIN kodi i urdhëruesit për printim.
- A** – A është shkurtesë për fjalën Automatik (Automatik), që dmth printer ofron funksione automatike të veprimit.
- D** – D është shkurtesë për fjalën Duplex, që dmth se printeri mund të shtypë në të dy anët e një faqeje.
- Ë** – Ë është shkurtesë për fjalën Wireless, që dmth se printeri ka aftësi të printimit përmes valëve pa kablo dhe atë nga kompjuterët, tabletat apo edhe telefonat e mençur.
- E** – E është shkurtesë për fjalën e Print, që dmth printer ka aftësi të printoj edhe nga Emili. Printerët të cilët janë MFP (Printerë me shumë funksione) zakonisht përmbajnë këtë funksionalitet.

Modeli i ofruar nga OE ankues përkrah këtë funksion.

- MFP** – MFP është shkurtesë për fjalën Multi-Function Printer (Printer me Shumë Funksione). Printerët MFP janë printer AiO "all-in-one" me funksione bonus përfshirë skanimin, kopjimin dhe faksin.

OE ankues ka ofruar printerin AiO apo MFP.

OE ankues me te drejte ka ofruar printerin AiO, sepse printeri ofron shërbimet AiO. Ndërsa AK nuk ka pas të drejtë të eliminoj nga gara tenderuese OE ankues për këtë pikë.

Nga ana tjetër, OE ankues në përshkrimin e vetë nuk e ka dhënë modelin e saktë që do të ofrojnë, e ndoshta është gabim teknik në kolonën C, sepse në hulumtimin tonë ne nuk kemi mund të gjejmë modelin e ofruar në kolonën C edhe pse është printer i serisë së familjes MB2400. Por kemi gjetë modelin e ofruar nga katalogu. E ftojmë OE ankues të sqarohet në seancën dëgjimore se a ka qenë gabim teknik modeli i dhënë i printerëve, edhe pse me katalog kanë dëshmuar modelin e saktë të printerit ofertues.

Pika ankimore nga më lartë nr 2, nënpika nr. 2.2.

Pasi kemi deponuar Raportin e Ekspertizës përmes emailt në OSHP dhe te palët e përfshira, OE ankues - ILIR Kosova, Prishtinë është përgjigj përmes emailit të, në lidhje me lëndën ankimore në OSHP Nr. 304/19, lidhur me aktivitetin “Furnizim me pajisje teknologjike për Objektet Komunale dhe Bashkësitë Lokale, LOT 2 – Furnizim me Printer AiO“ me nr. të Prokurimit: 616-19-1461-121, iniciuar nga AK Komuna e Prishtinës për kundërshtim të Raportit të Ekspertizës dhe komentim të pikës ankimore Nr. 2. Nën-pika 2.2, ku kemi vlerësuar se OE ankues ka plotësisht të drejtë të kundërshtoj këtë pike ankimore të Ekspertit Teknik e që dëshirojmë të përmirësoj dhe të plotësoj përgjigjen tonë në Raportin e Ekspertizës.

OE ankues ka plotësisht të drejtë të kundërshtoj Raportin e Ekspertizës tonë Nr. 304/19, për shkak se pika ankimore Nr. 2. Nën-pika 2.2. nuk është shtjelluar mjaft dhe përmban gabime në vlerësim, prandaj kërkojmë të zëvendësohet në tërësi për pikën nr. 2 Nën-pika 2.2. përgjigja e Ekspertit Teknik në Raportin e Ekspertizës për lëndën Nr. 304/19 të dt. 17.06.2019 dhe atë me tekstin si në vijim;

AK në DT ka kërkuar që printeri të ketë funksionalitetin DADF, ndërsa OE Ankues ka ofruar RADF.

Printerët AiO përkrahin dy tipare të ADF-ve (Automatic Document Feeder), që të dy këto tipare (lloje të ADF-ve); DADF dhe RADF mundësojnë që të skenohen faqet në të dy anët në mënyrë automatike. Në vijim, përshkruajmë procesin e skanimit/leximit dhe dallimin ndërmjet këtyre dy tipareve të printerëve multifunksional ADF;

DADF (Duplex Automatic Document Feeder) - skanon të dy anët e faqes në të njëjtën kohë në mënyrë automatike dhe atë duke kaluar vetëm një herë përmes skanimit/leximit.

RADF (Reverse Automatic Document Feeder) - skanon njëërën anë të faqes, pastaj rrokullis letrën për të skanuar faqen tjetër, poashtu në mënyrë automatike. Letra gjatë skanimit kalon dy herë (njëërën faqe një herë, pastaj faqen tjetër) përmes të njëjtit skener për lexim.

Të dyja këto tipare, DADF dhe RADF kryejnë të njëjtin proces të punës dhe rezultati është i njëjtë në fund, por se funksionaliteti i procesit të punës ndryshon për DADF dhe RADF.

Ndërsa, RADF në krahasim me DADF është pak më i ngadalshëm në lexim/skenim të faqeve dhe ka gjasa më të mëdha për të kërcyer (bllokuar) letrën për shkak të gumicave rrotulluese që shërbejnë për përcjelljen e letrës.

AK në specifikacionin teknik të DT-së ka kërkuar DADF, ndërsa OE ankues ka ofruar RADF. Edhe pse të dyja këto tipare kryejnë të njëjtën punë në mënyra/procese të ndryshme, por që rezultati në fund është i njëjtë, por dallon në mënyrën e punës sikurse e kemi përshkruar më lart, konsiderojmë që prapë se prapë OE ankues nuk e ka ofruar saktësisht tipin e printerit që AK ka kërkuar edhe pse është shumë afër por jo identik sipas kërkesave të AK-së. Prandaj, OE ankues nuk i japim të drejtë në këtë pike ankimore, sepse nuk ka ofruar saktësisht funksionalitetin e kërkuar të printerit sikurse në DT.

Gjithashtu, në ankesën e vet OE ankues po nënvizuar që OE i shpallur fitues potencial nga AK nuk ka ofruar printer që përmban ADF (Automatic Document Feeder), ndërsa OE i shpallur fitues nga AK-ja, ka ofruar printerin BROTHER DCP-L6600DË i cili përmban ADF-në.

Kërkojmë ndjesë për plotësimin e kësaj Ekspertize 304/19 për këtë pikë ankimore 2, Nën-pika 2.2., njëkohësisht falënderoj OE ankues, AK dhe komisionin e OSHP-së që me punën e tyre kontribuojnë në zvogëlimin e gabimeve eventuale që mund të lëshohen gjatë punëve.

Eksperti teknik, bazuar në sqarimet e cekura më lartë në raport mendon që Autoriteti Kontraktues, AK – Komuna Prishtinës, për këtë aktivitet të prokurimit: “Furnizim me Pajisje Teknologjike për Objektet Komunale dhe Bashkësitë Lokale, LOT 2 – Furnizim me Printer All In One”, me nr. të Prokurimit: 616-19-1461-121, REKOMANDON, panelit shqyrtues që të Aprovoj Pjesërisht të bazuar ankesën e OE ankues dhe njëherit AK-së të Vazhdoj Tutje me prokurimin e këtij aktiviteti deri në realizimi të suksesshëm të tij.

Pas vlerësimit të dytë të dhënë në raportin e ekspertizës AK me datën 15 korrik 2019 ka deklaruar se pajtohen pjesërisht me raportin e ekspertizës ndërsa OE ankues me datën 11 korrik 2019 ka deklaruar se pajtohet pjesërisht me ekspertizën.

Paneli shqyrtues pas shqyrtimit të shkresave të lëndës, shqyrtimit të pretendimeve ankimore të OE ankues, konstatimeve, analizës konkrete dhe rekomandimeve të ekspertit shqyrtues profesional, deklarimit të palëve në procedurë, diskutimeve dhe shoshitjes së provave në tërësi konstatoj se AK në DT ka kërkuar që printeri të ketë funksionalitetin DADF, ndërsa OE Ankues ka ofruar RDAF. Eksperti shqyrtues teknik ka sqaruar në raportin e ekspertizës se cilit raport paneli shqyrtues ja fal besimin se printerët AiO përkrahin dy tipare të ADF-ve (Automatic Document Feeder), që të dy këto tipare (lloje të ADF-ve);

DADF dhe RADF mundësojnë që të skenohen faqet në të dy anët në mënyrë automatike. DADF (Duplex Automatic Document Feeder) - skanon të dy anët e faqes në të njëjtën kohë në mënyrë automatike dhe atë duke kaluar vetëm një herë përmes skanimit/leximit. RADF (Reverse Automatic Document Feeder) - skanon njërën anë të faqes, pastaj rrokullis letrën për të skanuar faqen tjetër, poashtu në mënyrë automatike. Letra gjatë skanimit kalon dy herë (njëherë faqe një herë, pastaj faqen tjetër) përmes të njëjtit skener për lexim.

Të dyja këto tipare, DADF dhe RADF kryejnë të njëjtin proces të punës dhe rezultati është i njëjtë në fund, por se funksionaliteti i procesit të punës ndryshon për DADF dhe RADF.

Ndërsa, RADF në krahasim me DADF është pak më i ngadalshëm në lexim/skenim të faqeve dhe ka gjasa më të mëdha për të kërcyer (bllokuar) letrën për shkak të gumicave rrotulluese që shërbejnë për përcjelljen e letrës.

AK në specifikacionin teknik të DT-së ka kërkuar DADF, ndërsa OE ankues ka ofruar RADF. Edhe pse të dyja këto tipare kryejnë të njëjtën punë në mënyra/procese të ndryshme, por që rezultati në fund është i njëjtë, por dallon në mënyrën e punës sikurse e kemi përshkruar më lart, konsiderojmë që prapë se prapë OE ankues nuk e ka ofruar saktësisht tipin e printerit që AK ka kërkuar edhe pse është shumë afër por jo identik sipas kërkesave të AK-së. Prandaj, OE ankues nuk i japim të drejtë në këtë pike ankimore, sepse nuk ka ofruar saktësisht funksionalitetin e kërkuar të printerit sikurse në DT. Paneli shqyrtues konstaton se eksperti shqyrtues teknik ka sqaruar se OE ankues nuk ka ofruar printer që përmban ADF (Automatic Document Feeder), ndërsa OE i shpallur fitues nga AK-ja, ka ofruar printerin BROTHER DCP-L6600DË i cili përmban ADF-në.

Paneli shqyrtues me tej konstaton se modeli i ofruar nga OE ankues përkrah funksionin MFP që është shkurtesë për fjalën Multi-Function Printer (Printer me Shumë Funksione). Printerët MFP janë printer AiO "all-in-one" me funksione bonus përfshirë skanimin, kopjimin dhe faksin.

OE ankues ka ofruar printerin AiO apo MFP, andaj duke pasur parasysh këtë, paneli shqyrtues konstaton se OE ankues me të drejtë ka ofruar printerin AiO, sepse printeri ofron shërbimet AiO. Ndërsa AK nuk ka pas të drejtë të eliminojë OE ankues për këtë pikë.

Nga ana tjetër, OE ankues në përshkrimin e vetë nuk e ka dhënë modelin e saktë që do të ofrojnë, e ndoshta është gabim teknik në kolonën C, sepse në hulumtimin tonë ne nuk kemi mund të gjejmë modelin

e ofruar në kolonën C edhe pse është printer i serisë së familjes MB2400. Por kemi gjetë modelin e ofruar nga katalogu.

Paneli shqyrtues konform nenit 117 të LPP-së, si dhe duke u bazuar në provat e prezantuara si më lart vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

KËSHILLË JURIDIKE:

Kundër këtij vendimi nuk është e lejuar ankesa, por pala e pakënaqur me kërkesëpadi mund t'i drejtohet vetëm Gjykatës themelore-Departamentit për çështje Administrative për anulim vendimi ne afat prej 30 ditësh nga data e pranimi të vendimit .



Vendimi t'i dorëzohet:

1x1 AK – KK Prishtinës

1x1 OE ankues

1x1 Arkivës së OSHP-së;

1x1 Për publikim në ueb- faqe të OSHP-së.